



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:112012

Datë: 10.08.2022

Numri i dokumentit: 03316118

PKR.nr.102/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti I Krimeve të Rënda, përmes Trupit gjykues -gjyqtarve Ramiz Azizi kryetar dhe Islam Thaqi e Sahit Boroci-antarë, me zyrtaren ligjore A.B në lëndën penale ndaj të akuzuarit I.R nga fshati . k.e Gjilanit, të cilët me autorizim e mbrojnë avokatët Shaban dhe Milot Spahiu, që të dy nga Gjilani, për shkak të veprës penale Keqpërdorimi I pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 paragrafi 1 I KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti I Krimeve të Rënda, PP.I.nr.118/2022 të datës 01.06.2022, të cilën e përfaqësonte prokurori i shtetit, Mr.sci Isuf Sadiku, pas mbajtjes në seancën kryesore gjyqësore, publike dhe orale lidhur me marveshjen mbi pranimin e fajsisë dhe dënimit në Prokurori PP.I.nr.118/22 të datës 13.07.2022 ,me datë 10.08.2022 publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari I.R nga i ati I ., dhe nëna S. e lindur S., i lindur me datë në fshatin . komuna e Gjilanit ku edhe tani jeton , i pa martuar ,babë I tre fëmijve, e ka të kryer fakultetin ekonomik,i punësuar Drejtorinë e administrates komunale në Gjilan , i gjendjes së varfër ekonomike,me nr. Personal . Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE

Nga viti 2016 e deri në vitin 2022, i pandehuri në cilsinë e personit zyrtar në Shërbimin e gjendjes civile në fshatin .he fshatin e . duke shfrytëzuar detyren apo autoritetin e tij zyrtar, me qëllim të përfitimit të qfardo dobie për vete apo personin tjetër, apo që ti shkaktojnë dëm personit tjetër, me dashje, ka tejkaluar kompetencat dhe ka shkelur detyrat e tija të domosdoshme të përcaktuara me ligj, duke vepruar në kundërshtim me nenin 32 të Ligjit të Shtetësisë së Republikës së Kosovës dhe me nenin 9 par.4 dhe nenin 11 par.2 të Udhëzimit Administrativ 18/2013, në at mënyrë që personal e poshtshënuar, i ka regjistruar si banor të

shtetit të Kosovës, dhe ate: V. . ka marrë pension deri me datë 20 mars 2017 (lajmërimi i fundit 06 qershor 2016), D. V., merr pension nga viti 2019-vazhdon(lajmërimi i fundit shkurt 2022), B. D. merr pension që nga viti 2019-vazhdon (lajmërimi i fundit 01 nëntor 2022), Babiq Gordana prej vitit 2019- vazhdon(lajmërimi i fundit 01 Nëntor 2021),prej vitit 2019-vazhdon, me këto veprime i pandehuri e ka dëmtuar Ministrinë e Financave, Punës dhe transfereve-Buxhetin e Republikës së Kosovës në shumë të papërcaktuar.

-me çka ka kryer veprën penale keqpërdorim i detyrës apo autoritetit nga neni 414 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur, si dhe në nenet 4,7,17,21,38,42,44,69,70,71,72 të KPRK-së si dhe te neneve 233,247, 365,451 e 463 të KPPRK-ës atij i shqipton

DENIM ME BURGIM TE SHENDRRUAR NE GJOBË

Të akuzuarit I. R. i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njqindetdhjetë) ditëve, e me pëlqimin e tij konform nenit 44 të KPRK-së i shëndrrohet në dënim me gjobë në shumë prej 6000 (gjashtëmijë) Eurove,e në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e qëndrimit të tij nën masat e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak prej datave 05.05.2022 e deri me 29.06.2022 gjithsejt 59 ditë-ku një ditë i llogaritet baras me 20 Euro e gjithsejt 1220 Euro , i zbriten nga 6000, e për pagesë i mbeten edhe 4880 (katërmijetëqindetdhjetë) Euro, të cilat ai duhet ti paguaj në afatin prej 90 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

E dëmtuara Ministria e Financave,Punës dhe Transvereve e Republikës së Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontestin civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë 50 (pesdhjetë) euro si dhe në emër të viktimave të krimit ti paguaj 50 (pesdhjetë) Euro, të gjitha këto në afatin 15 ditor pas marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda ka paraqitur aktakuzen PP.I.nr.118/2022 të datës 01.06.2022, kundër të akuzuarit I. R. nga fshati . Komuna e Gjilanit, për shkak të vepres penale keqpërdorimi I pozitës apo autoritetit nga neni 414 paragrafi 1 të KPRK-së.

Asnjëra palë nuk e kundërshtoi trupin gjykues, nuk pati asnjë vërejte ndaj të njëjtit.

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë si dhe të sanksionit penal i është paraqitur gjyqtarit të vetëm gjykues konform nenit 233 të KPPRK-së më datën 13.07.2022, e cila si e tërë është edhe pjesë përbërëse e kësaj lënde penale.

Për veprën penale në fjalë nga neni 414 par.1 të KPRK-së, është paraparë dënimi me burgim prej 1 deri në 8 vit.

Përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Gjilan, prokurori i shtetit Mr.sci. Isuf Sadiku, e ka njoftuar trupin gjykues për dhënien e pëlqimit me shkrim nga ana e kryeprokurorit dhe për lidhjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal, duke hequr dorë nga dëgjimi i dëshmitarëve të propozuar si dhe të shtjellimit të provave të tjera materiale.

Mbrojtësit e të akuzuarit I. R., avokatët me autorizim Shaban dhe Milot Spahiu që të dy nga Gjilani, e kanë njoftuar trupin gjykues gjykues për marrëveshjen në fjalë të lidhur me përfaqësuesin e akuzës në prezencën e të akuzuarit, duke hequr dorë nga dëgjimi i dëshmitarëve dhe të shtjellimit të provave tjera, po ashtu duke kërkuar që dënimi për të akuzuarin të jetë dënim me gjobë e që të njëjtin nuk e kundërshtoi as prokurori, e as gjyqtari i vetëm gjykues e i cili këtë edhe e aprovoi.

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë dhe të sanksionit penal për të akuzuarin, i përmbajnë të gjitha kushtet, duke bërë propozim për marrëveshjen e pranimit të fajësisë dhe sanksionimit penal, e bërë në mënyrë vullnetare, duke deklaruar edhe për arsyet e pranimit të fajësisë si dhe të sanksionit penal.

Gjykata ka gjetur se palët procedurale marrëveshjet në fjalë i kanë bërë konform dispozitës ligjore të nenit 233 të KPPRK-së.

Gjykata është e bindur se i akuzuari e ka kryer veprën penale nga neni 414 i KPRK-së, si dhe ka konstatuar se nuk ekziston asnjë diskualifikim i cekur nga neni 233 të KPPRK-së.

Pasi që palët procedurale, prokurori i shtetit, i akuzuari dhe mbrojtësit e tij që ishte prezent në seancën dëgjimore, kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë dhe të sanksionit penal, gjykata atë e mori dhe e pranoi pa kurrfarë hezitimi si të arritur me vullnet nga palët procedurale.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit ndaj të akuzuarit në fjalë, trupi gjykues mori për bazë marrëveshjen mbi pranimin vullnetar të fajësisë dhe të sanksionit penal ndaj të akuzuarit të lartcekur si dhe rrethanat tjera lehtësuese si sjelljen korrekte në gjykatë, pendimin për atë qka kishte bërë, premtimin se një gjë të tillë atë kurrë nuk do ta përsërisë, është, hera e parë që ndeshet me ligjin, e si rrethana rënduese mori parasysh vendin e kryerjes së veprës në vend publik, si dhe pasojat e shkaktuara të dëmtuarës.

Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar me gjobë është në harmoni me peshën e veprës penale, kështu që me këtë dënim do të mundet të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me neni 38 të KPRK-së.

Përfaqësuesi i aktakuzës dhe mbrojtësit e tij deklaruan se heqin dorë nga ankesa.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 451, e aim bi kërkesën pasurore-juridike, në nenin 463 të KPPRK-së, ndërsa aim bi kompenzimin e viktimave, është i bazuar në nenin 39 të Ligjit mbi mbrojtjen e viktimave të krimit të Republikës së Kosovës.

Andaj, nga të lartcekurat conform nenit 46, 451 dhe 463 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti I Krimeve të Rënda
PKR.nr. 102/2022 të datës 10.08.2022

Zyrtarja ligjore,
Adelina Brestovci,

Kryetari i trupit gjykues
Ramiz Azizi

KËSHILLA JURIDIKE Kundër këtij aktgjykimi, mund të bëhet ankesë në afatin prej 15 ditëve nga pranimi I të njejtit në Gjykatën e Apelit të Kosovës, e ankesa dorzohet në kopje të mjaftueshme përmes Gjykatës Themelore në Gjilan.